



Nasa Iniciativa NASA

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur

01 Janar 2021 - 31 Dhjetor 2021

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3-5
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Informata të përgjithshme	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9-13

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë se Nasa Iniciativa-NASA

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i opinionit

Ne kemi qen të angazhuar për të audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik “Nasa Iniciativa ” (në vijim referuar si “Subjekti Politik” si “NASA”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2021, Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë , dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqet prej 9-13.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të vitit 2021 të subjektit politik “Nasa Iniciativa”. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme dhe të mjaftueshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për Mohim të Opinioneve

- Subjekti Politik Nasa Iniciativa nuk ka plotësuar drejt pasurinë, ekuitetin dhe detyrimet me 31 Dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020, po ashtu shënimet e prezantuara në Pasqyrat Financiare nuk mbështeten me dëshmi relevante lidhur me zërat e pasqyrave financiare të SP me 31 Dhjetor 2021 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuara dhe plotësuara me ligjin Nr. 04/L-058, Neni 15 Raportimi Financiar. Për me tepër subjekti politik nuk ka prezantuar dokumentacion mbështetës për asetet, ekuitetin dhe detyrimet e prezantuara me 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020, prandaj, duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban subjekti politik, ne e kishim të pamundur të përcaktojmë korrigjimet e nevojshme me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.
- Subjekti politik nuk ka ofruar dëshmi mbështetëse për te hyrat dhe shpenzimet e prezantuara për periudhën 01 Janar 2021 deri me 31 Dhjetor 2021 prandaj ne nuk ishim në gjendje të japim një opinion në lidhje me te hyrat dhe shpenzimet e njohura në pasqyrën e të ardhurave apo pajtueshmërinë e tyre me ligjin Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuara dhe plotësuara me ligjin Nr. 04/L-058.

Theksim i çështjes

Ne po ashtu tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur kontabilitet të mirëfilltë për të mundësuar regjistrimin e të gjitha transaksioneve financiare të ndodhura dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.

- Subjekti Politik në blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedurë të tenderimit e cila do të mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksionet financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka llogari bankare aktive .

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likujdojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të

një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Muhamet Feka
Auditor Ligjor
18 Tetor 2023

NASA INICIATIVA-NASA

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2021	Me 31 Dhjetor 2020
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5	150.00	50.00
Pasuritë e paprekshme		0.00	0.00
Pasuritë tjera afatgjata		0.00	0.00
Total pasuritë afatgjata		150.00	50.00
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme	6	0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	100.00	0.00
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		100.00	0.00
Total pasuritë		250.00	50.00
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		0.00	0.00
Suficiti / (deficiti) i vitit		440.00	0.00
Total Ekuiteti		440.00	0.00
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme		0.00	0.00
Të hyrat e shtyera		200.00	100.00
Gjithsej detyrimet afatgjata		200.00	100.00
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	0.00	0.00
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	200.00	0.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		200.00	0.00
Gjithsej detyrimet		400.00	100.00
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		840.00	100.00

NASA INICIATIVA-NASA*Pasqyrat Financiare më dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021***Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve**

	Shënimi	Viti që përfundon me 31	
		2021	Dhjetor 2020
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		0.00	0.00
Të hyrat nga anëtarësia		650.00	
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	0.00	0.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4	0.00	0.00
Të hyrat e fushatës		0.00	0.00
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera	5		
Të hyrat tjera			
Gjithsej të hyrat për vitin		650.00	0.00
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	2	0.00	0.00
Shpenzimet e transportit	2	30.00	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	30.00	0.00
Shpenzimet e fushatës	2	0.00	0.00
Blerja e mallrave	2	50.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme	2	50.00	0.00
Shpenzimet e ndryshme	2	50.00	0.00
Gjithsej shpenzimet për vitin		210.00	0.00
Suficiti / (deficiti) për vitin		440.00	0.00

1. Informata te përgjithshme

NASA INICIATIVA-NASA

Udhëheqja: Osman Gjugjeviq (Kryetar i partisë)
Përfaqësues i autorizuar financiar – Asmed Sezairi
Prezentuesi gjat Auditimit Almir Miftari
Selia e partisë: Rr. 28 Septembar ,Fshati Reqanë ,
Prizren.

Pasqyrat financiare të Nasa Iniciativa (më tutje “NASA”) janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara mund ta dorëzoj raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik nuk është gjetur se mirëmbanë llogari kryesore bankare në bankat në Kosovë.

NASA INICIATIVA-NASA

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor 2021

Shënimi 2. Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	0.00	0.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	0.00	0.00	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit			
Tatimet në të ardhura personale			
Beneficionet tjera	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	50.00	50.00	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	20.00	20.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	30.00	30.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	100.00	100.00	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	30.00	30.00	0.00
Ushqimi	20.00	20.00	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta	50.00	50.00	0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	30.00	30.00	0.00
Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	130.00	130.00	0.00
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	100.00	100.00	0.00
Pajisjet të vogla	50.00	50.00	0.00
Gjithsej blerja e mallrave	150.00	150.00	0.00

NASA INICIATIVA-NASA

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor 2021

Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	200.00	200.00	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	30.00	30.00	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	30.00	30.00	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë		////////////////////	////////////////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		////////////////////	////////////////////
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	260.00	260.00	0.00
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	60.00	60.00	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër			0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	60.00	60.00	0.00
Gjithsej shpenzimet	700.00	700.00	0.00

Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
						✓
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				0.00	0.00	0.00

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					0.00

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka					0.00
Objektet					
Veturat					
Pajisjet e zyrës	100.00	50.00			150.00
Pajisjet e teknologjisë informative	0.00	150.00			150.00
Pajisjet tjera					
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	100.00	200.00			300.00

Shenime tjera

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro
.....bleresi 1		
.....bleresi 2		
Gjithsej Llogarit e arkëtueshme	0.00	0.00

NASA INICIATIVA-NASA*Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor 2021*

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro
Paraja në bankë	0.00	0.00
Paraja në arkë	450.00	0.00
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	450.00	0.00

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro
.....furnitori 1		
.....furnitori 2		
.....furnitori 3		
.....furnitori 4		
Llogari te pagueshme te tjera		
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	0.00	0.00

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	0.00	0.00
Detyrimet për qira	200.00	0.00
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	0.00	0.00
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)	50.00	0.00
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	250.00	0.00

